



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.2, 1.4, 1.6, 1.7, nenit 17, 18 dhe 19 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 83 dt. 29 tetor 2010 dhe të nenit 2 paragrafi 2.1.28 dhe paragrafi 2.1.31 të Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 17 dt. 30 qershor 2015, si dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi 1.7 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, në mbledhjen e mbajtur më 01 dhjetor 2015, miraton:

**RR E G U L L O R E NR.07/2015**  
**PËR**  
**REKRUTIMIN, PROVIMIN, EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E PROKURORËVE**  
**TË SHETIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat e rekrutimit, emërimit dhe ri-emërimit të prokurorëve të shtetit më saktësisht, shpalljes së konkursit për prokurorë të shtetit, hartimit, vlerësimit dhe organizimit të provimit për kandidatët për prokurorë të shtetit. Gjithashtu rregullohet themelimi, kompetencat dhe mandati i Komisionit për Rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim, si dhe procesi i vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve për prokurorë dhe propozimet për emërim të prokurorëve të shtetit.

2. Dispozitave të kësaj rregullore iu përmbahen të gjithë kandidatët për prokurorë të shtetit gjatë procesit të rekrutimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës (më tutje KPK), anëtarët e Komisionit për Rekrutim dhe Komisionit për Rishqyrtim si dhe personeli i KPK-së të cilët janë të përfshirë për zbatim të kësaj rregulloreje.

**Neni 2**  
**Bashkëpunimi**

Për qëllim të zbatimit të kësaj Rregulloreje, Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Institutin Gjyqësor të Kosovës, me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe me institucione të tjera relevante.

### Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet si më poshtë:
  - 1.1. **KPK** - nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës;
  - 1.2. **PSh** - nënkupton Prokurorin e Shtetit;
  - 1.3. **Provimi** - nënkupton provimin për kandidatet për prokurorë të shtetit dhe përfshinë testin kualifikues, testin me shkrim dhe intervistën me gojë;
  - 1.4. **Komisioni për Rekrutim** - nënkupton Komisionin e KPK-së përgjegjës për organizimin dhe sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës së rekrutimit, hartimin dhe vlerësimin e provimit si dhe vlerësimin e kandidatëve për prokurorë;
  - 1.5. **Komisioni për Rishqyrtim**- nënkupton Komisionin e KPK-së për rikonsiderim të ankesave të kandidateve në procesin e rekrutimit për prokurorë të shtetit;
  - 1.6. **Emërimi** - nënkupton emërimin e kandidatit për prokurorë të shtetit për të ushtruar funksionin e prokurorit me mandat fillestar tre (3) vjeçar;
  - 1.7. **Riemërim** - nënkupton përfundimin me sukses të mandatit fillestar të prokurorit të emëruar i cili pas vlerësimi pozitiv propozohet nga KPK për emërim me mandat të përhershëm;
  - 1.8. **NjShPP** - nënkupton Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

### Neni 4 Komisioni për Rekrutim

1. KPK me shumicë të thjeshtë votash emëron Komisionin për Rekrutim, në bazë të kritereve të përcaktuara me këtë rregullore.
2. Komisioni për Rekrutim ka përgjegjësi kryesore sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës së emërimit të kandidatëve për prokurorë të shtetit, për zgjedhjen preliminare të kandidatëve, hartimin dhe vlerësimin e provimit, vlerësimin e kandidatëve si dhe dërgimin e listës me kandidatët më të suksesshëm në KPK.
3. Për tu zgjedhur si anëtarë i Komisionit për Rekrutim, kandidatët duhet që:
  - 3.1. të kenë përvojë si prokurorë me mandat të përhershëm;
  - 3.2. të jenë të dëshmuar për aftësi organizative, trajnuese apo vlerësuese;
  - 3.3. të jenë prokurorë ndaj të cilëve nuk janë shqiptuar masa disiplinore dhe të cilët kanë reputacion të lartë profesional.

**Neni 5**  
**Përbërja dhe mënyra e punës së Komisionit për Rekrutim**

1. Komisioni për Rekrutim përbëhet nga pesë (5) anëtarë të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezervë.
2. Anëtarë të rregullt të Komisionit për Rekrutim janë:
  - 2.1. Kryeprokurori i Shtetit, kryetar i komisionit;
  - 2.2. Një (1) prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
  - 2.3. Një (1) prokurorë nga Prokuroria e Apelit, dhe
  - 2.4. Dy (2) prokurorë nga niveli themelor.
3. Anëtarët rezervë të Komisionit për Rekrutim janë; një (1) prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe një (1) prokurorë nga Prokuroria e Apelit. Anëtarët rezervë zëvendësojnë anëtarët e rregullt në rast të konfliktit të interesit apo rasteve të tjera të pengesave për ushtrimin e detyrës së tyre.
4. Me rastin e themelimit të Komisionit për Rekrutim, KPK do të ketë parasysh përbërjen etnike dhe gjinore të këtij komisioni, kur një gjë e tillë është e mundur.
5. KPK me rastin e shpalljes së konkursit për prokuror në të njëjtën kohë e formon edhe Komisionin për Rekrutim.
6. Anëtarët e Komisionit për Rekrutim kompensohen për punën e kryer në bazë të vendimit të KPK-së.
7. Anëtarët e Komisionit për Rekrutim në punën e tyre duhet që:
  - 7.1. Gjithçka që ka të bëjë me pyetjet dhe përgjigjet e provimit t'i mbaj rreptësisht në fshehtësi;
  - 7.2. Të mos marr as jap askujt kopje të provimit të hartuar apo mostra të tij;
  - 7.3. Ti përmbahet të gjitha rregullave dhe procedurave lidhur me hartimin, vlerësimin dhe organizimin e provimit;
  - 7.4. Të mos publikojë dhe diskutojë informata lidhur me vlerësimin e kandidatëve për prokurorë të shtetit gjatë tërë procesit të rekrutimit të tyre.
8. Në rast të shkeljes së rregullave nga paragrafi 7 i këtij neni, anëtari i Komisionit për Rekrutim përjashtohet nga komisioni dhe sjellja e tij konsiderohet shkelje e rëndë e Kodit të Etikës Profesionale për Prokurorë.

**Neni 6**  
**Komisioni për Rishqyrtim**

1. KPK emëron Komisionin për Rishqyrtim në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, prej të cilëve një (1) anëtarë do të jetë nga radha e anëtarëve të KPK-së, një (1) anëtar prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe një (1) anëtar prokuror i Prokurorisë së Apelit.

2. KPK emëron Kryetarin e Komisionit për Rishqyrtim, zëvendësin e tij si dhe cakton dy (2) anëtarë rezervë, të cilët zëvendësojnë anëtarët në rast të konfliktit të interesit apo rasteve të tjera të pengesave për ushtrimin e detyrës së tyre. Anëtarët rezervë të Komisionit për Rishqyrtim janë, një (1) prokurorë nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) prokurorë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

3. Gjatë vendosjes për përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim, KPK merr parasysh parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin e minoriteteve, kur një gjë e tillë është e mundur.

4. Komisioni për Rishqyrtim ka kompetencë kryesore shqyrtimin e ankesave të kandidatëve ndaj vendimeve të Komisionit për Rekrutim.

5. Për qëllime të paragrafit 4 të këtij neni shqyrtimi i ankesave nënkupton vlerësimin e respektimit nga Komisioni për Rekrutim të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën dhe kriteret e përcaktuara me këtë rregullore, por jo edhe me vlerësimin e bërë nga Komisioni për Rekrutim.

6. Anëtarët e Komisionit për Rishqyrtim kompensohen për punën e kryer në bazë të vendimit të KPK-së.

#### **Neni 7**

#### **Administratori i Rekrutimit dhe Provimit**

1. Administratori i rekrutimit dhe provimit caktohet nga KPK.

2. Administratori i rekrutimit dhe provimit kryen të gjitha veprimet e nevojshme administrative në mënyrë që puna e Komisionit për Rekrutim të jetë funksionale. Për punën e tij administratori koordinohet me Kryesuesin e Komisionit për Rekrutim.

3. Administratori i rekrutimit dhe provimit ka përgjegjësi ruajtjen e fshehtësisë së procesit të rekrutimit siç është përcaktuar me këtë rregullore dhe çdo shkelje eventuale në këtë proces konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës dhe trajtohet sipas ligjeve në fuqi.

4. Për realizimin e përgjegjësisë së tij Administratori i rekrutimit dhe provimit ndihmohet nga zyrtarët e caktuar të KPK-së.

## Neni 8

### Shpallja e konkursit dhe përzgjedhja preliminare

1. Konkursi përmes së cilit bëhet shpallja publike e vendeve të lira për prokurorë të shtetit shpallet me vendim të KPK-së dhe publikohet në së paku një (1) gazetë të përditshme me shpërndarje në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe në faqen e internetit të KPK-së dhe PSh-së. Me qëllim të informimit të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë, konkursi publikohet edhe në media të komuniteteve jo-shumicë në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në Republikën e Kosovës.
2. Para shpalljes së konkursit, KPK sigurohet se ka bërë vlerësimin e nevojave dhe caktimin e numrit të prokurorëve, ashtu siç kërkohet me Ligjin për KPK-në.
3. Shpallja e vendeve të lira përmban të gjitha informatat përkatëse, duke përfshirë:
  - 3.1 numrin e pozitave të lira për prokurorë të shtetit, në nivel të Republikës së Kosovës;
  - 3.2 përshkrimin e pozitës e cila shpallet me konkurs;
  - 3.3 kriteret lidhur me kualifikimin e kandidatëve për prokurorë të shtetit;
  - 3.4 afatin e fundit për dorëzimin e aplikacionit, i cili në asnjë rrethanë nuk mund të jetë nën 15 ditë kalendarike nga shpallja e konkursit.
4. Kandidatët për prokurorë të shtetit, duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:
  - 4.1 Aplikacionin standard që përgatitet nga ana e KPK-së;
  - 4.2 Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
  - 4.3 Diplomën e Fakultetit Juridik të vlefshme në Kosovë;
  - 4.4 Çertifikatën e vlefshme mbi dhënien e provimit të jurisprudencës;
  - 4.5 Çertifikatën që vërteton se kandidati nuk është i dënuar për vepër penale, siç është caktuar me ligjet në fuqi;
  - 4.6 Dëshminë mbi përvojën e punës siç është përcaktuar me Ligjin Për KPK-në.
5. Kandidatët duhet të dorëzojnë informatat e siguruara nga punëdhënësi për tre (3) vitet e fundit të përvojës profesionale të cilat përfshijnë përshkrimin e detyrave të punës, performancën profesionale, masat eventuale disiplinore dhe çështje tjera që konsiderohen relevante, të shoqëruara me dokumente mbështetëse, për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale siç parashihen me këtë Rregullore dhe nenin 18 të Ligjit për KPK-në.
6. Kandidatët dorëzojnë, nëse posedojnë edhe dokumentacionin si në vijim:
  - 6.1 publikime profesionale apo akademike, të kryera nga ai;
  - 6.2 informata për pjesëmarrje në forma të organizuara të trajnimit në të cilat është vlerësuar performanca;

7. Të gjitha aplikacionet regjistrohen në zyrën e pranimit të KPK-së dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

8. Për secilin kandidat krijohet një dosje e cila përmban të gjitha dokumentet e prezantuara nga kandidati. Komisioni për Rekrutim është përgjegjës për mbajtjen e dosjes dhe siguron kompletimin dhe përditësimin e tyre deri në momentin e shpalljes së rezultatit final të provimit.

9. Vetëm kandidatët e regjistruar në KPK, në afatin e paraparë me konkurs për regjistrim kanë të drejtë t'i nënshtrohen procesit të rekrutimit.

## Neni 9

### Përzgjedhja preliminare

1. Komisioni për Rekrutim i shqyrton të gjitha aplikacionet e pranuar.

2. Konsiderohet se kandidatët i plotësojnë kriteret për pozita për të cilat aplikojnë, jo më vonë se data e skadimit të konkursit.

3. Kandidatët, të cilët nuk i dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara sipas nenit 8.4 të kësaj Rregulloreje brenda afatit si dhe kandidatët, të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj nuk merren në konsideratë dhe njoftohen që aplikacionet e tyre nuk merren parasysh më tutje. Njoftimi përmban arsyetimin e duhur.

4. Në rast të refuzimit të aplikacionit, kandidati njoftohet individualisht nga ana e Komisionit për Rekrutim mbi bazën e refuzimit në bazë të së cilës kandidati ka të drejtë ankese në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e njoftimit.

5. Ankesat e kandidatëve shqyrtohen nga Komisioni për Rishqyrtim në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e përfundimit të afatit për ankese.

6. Pas shqyrtimit të ankesave nga ana e Komisionit për Rishqyrtim, kandidatët që i plotësojnë kushtet për t'iu nënshtuar provimit njoftohen përmes web faqes zyrtare të KPK-së, PSh-së dhe adresës elektronike (e-mailit). Njoftimi përmban listën me emër dhe mbiemër të kandidateve edhe informatat për datën, vendin dhe detajet e duhura rreth organizimit të provimit.

## Neni 10

### Struktura e provimit

1. Provimi organizohet në tre pjesë; pjesa e parë përfshinë testin kualifikues, pjesa e dytë përfshinë testin me shkrim dhe pjesa e tretë përfshinë intervistën me gojë.

2. Testi kualifikues do të ketë pyetje me përgjigje alternative nga fusha penale, etika profesionale dhe të drejtat e njeriut.

3. Testi me shkrim përbëhet nga disa raste praktike të cilat përzgjidhen nga Komisioni për Rekrutim me qëllim të vlerësimit të njohurive, aftësive dhe shkathtësive të kandidatëve për analizimin e problemeve ligjore nga fusha e të drejtave të njeriut kushtetuese, penale (materiale dhe procedurale) dhe drejtësia për të mitur.

4. Intervista me gojë përmban pyetje të cilat vlerësojnë aftësitë e komunikimit dhe personalitetin e kandidatit.

#### **Neni 11 Hartimi i Provimit**

1. Provimi hartohet nga Komisioni për Rekrutim, në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe përkthehet në gjuhët zyrtare të përcaktuara me ligj.

2. Provimi hartohet në kushte dhe hapësira krejtësisht konfidenciale dhe të mbrojtura nga ndërhyrjet e jashtme.

3. Komisioni për Rekrutim e harton provimin i ndarë në grupe.

4. Me qëllim të ruajtjes së integritetit të procesit të organizimit të provimit, Komisioni për Rekrutim harton së paku dy grupe të testit kualifikues dhe testit me shkrim si dhe dy grupe të pyetjeve për intervistën me gojë. Grupet e testeve dhe pyetjeve për intervistë me gojë kanë zgjidhje dhe përmbajtje të ndryshme nga njëra tjetra.

5. Pyetjet që do të përdoren në testin kualifikues dhe intervistën me gojë hartohen nga anëtarët e Komisionit për Rekrutim në kohën e hartimit të provimit.

6. Rastet praktike për testin me shkrim i përzgjedhë dhe i përgatitë Komisioni për Rekrutim, nga grupi i rasteve të përzgjedhura nga praktika e punës së prokurorëve.

7. Kompjuterët ku hartohet provimi nuk duhet të kenë qasje në internet dhe pas përfundimit të hartimit, të gjitha testet fshihen nga kompjuterët, ndërsa origjinali ruhet në një disk, usb dhe kompjuter të cilat ndodhen nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komisionit për Rekrutim.

8. Gjatë hartimit të provimit, anëtarët e Komisionit për Rekrutim si dhe personeli mbështetës nuk mund të komunikojnë me telefon, internet apo mënyra tjera të komunikimit elektronik.

9. Fotokopjimi dhe përgatitja e kopjeve të mjaftueshme për provim, bëhet me mbikëqyrjen e Administratorit të Rekrutimit dhe provimit nën masa sigurie të cilat garantojnë konfidencialitet të plotë.

## **Neni 12** **Testi kualifikues**

1. Testi kualifikues ka për qëllim vlerësimin e njohurive të përgjithshme të kandidatëve lidhur me të drejtën penale (materiale, procedurale), përfshirë të drejtat e njeriut dhe etikën profesionale.
2. Testi kualifikues hartohet siç është përcaktuar në nenin 11 paragrafi 4 të kësaj Rregulloreje dhe përmban 60 pyetje me përgjigje alternative nga të gjitha fushat e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në fund të hartimit të testit kualifikues Komisionit për Rekrutim i kontrollon pyetjet dhe vendosë versionin me përgjigje të sakta.
4. Kryetari i Komisionit për Rekrutim siguron tërë dokumentacionin e testit kualifikues për ruajtje në një vend të sigurtë në lokalet e KPK-së.

## **Neni 13** **Njoftimi dhe mënyra e mbajtjes së testit kualifikues**

1. KPK i njofton kandidatët për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit kualifikues së paku dhjetë (10) ditë para mbajtjes së tij.
2. Njoftimi mbi kohën dhe vendin e mbajtjes së testit kualifikues u dërgohet kandidatëve me postë elektronike (email) si dhe publikohet në web-faqen e KPK-së dhe PSh-së.
3. Njoftimi për mbajtjen e testit kualifikues, përmban listën e kandidatëve, vendin dhe kohën e mbajtjes së testit.
4. Vendimin për publikimin e njoftimit nga paragrafi (3) të këtij neni e merr Komisioni për Rekrutim më së voni 3 ditë nga dita e përfundimit të procesit të përzgjedhjes preliminare të kandidateve, përfshirë shqyrtimin e ankesave nga Komisioni për Rishqyrtim.
5. Testi kualifikues zgjatë 120 minuta.
6. Koha e paraparë për testin kualifikues, llogaritet prej momentit kur jepet shenjë për fillimin e tij dhe gjatë tërë testimit, kandidati ka mundësi të përcjell kohën e mbetur për plotësimin e testit.

## **Neni 14** **Vlerësimi i testit kualifikues**

1. Vlerësimin e testit kualifikues e bën Komisioni për Rekrutim.
2. Çdo përgjigje e saktë e testit kualifikues vlerësohet me nga një pikë.
3. Në testin kualifikues kandidati mund të realizojë më së shumti 60 pikë.



4. Kandidati i cili ka arritur më pak se 45 pikë, nuk e kalon testin kualifikues.
5. Testi kualifikues vlerësohet me notën „kalon” respektivisht „nuk kalon” dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Rekrutim.
6. Kandidati i cili nuk e kalon testin kualifikues, nuk mund të marrë pjesë në procedurën e mëtejme të konkursit.
7. Rregullat që i referohen konfidencialitetit sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje përshtatshëmrisht zbatohen edhe me rastin e vlerësimit të testit kualifikues.
8. Komisioni për Rekrutim e vlerëson testin kualifikues vetëm në bazë të kodit sekret të shënuar në plikon ku ndodhet testi dhe atë jo më vonë se 8 ditë nga dita e mbajtjes së testit.
9. Pakoja me pliko në të cilat ndodhen testet hapet vetëm në ditën kur fillon vlerësimi dhe atë në prezencë të Komisionit për Rekrutim.
10. Secili test vlerësohet në bazë të çelësit të krijuar për këtë qëllim nga Komisioni për Rekrutim në momentin e hartimit të testit kualifikues.

#### **Neni 15**

##### **Njoftimi për rezultatet e testit kualifikues**

1. Komisioni për Rekrutim njofton kandidatët për rezultatet e testit kualifikues pas finalizimit të listës përfundimtare e cila përgatitet pas përfundimit të vlerësimit nga Komisioni për Rekrutim.
2. Lista e kandidatëve me pikët e arritura, publikohet në web-faqen e KPK-së dhe PSh-së, duke u ndarë në dy pjesë, në listën e kandidatëve që kanë kaluar dhe listën e kandidatëve që nuk e kanë kaluar testin kualifikues.
3. Njoftimi mbi rezultatet e testit kualifikues përmban emrin, mbiemrin dhe rezultatin e arritur.

#### **Neni 16**

##### **Testi me shkrim**

1. Testit me shkrim i nënshtrohen vetëm kandidatët të cilët me sukses e kalojnë testin kualifikues.
2. Testi me shkrim zhvillohet rreth dy rasteve praktike lidhur me të cilat Komisioni për Rekrutim cakton detyra konkrete.
3. Komisioni për Rekrutim do të përzgjedhë raste praktike me qëllim të formimit të dy grupeve të testit me shkrim dhe i përgatitë ato për provim.

4. Rastet praktike për testin me shkrim përzgjidhen nga grupi i rasteve të përgatitura nga Komisioni për Rekrutim, në mënyrë të rastësishme në ditën e testimit, nga njëri prej kandidatëve në prani të të gjithë kandidatëve të tjerë.

5. Kandidatëve u vihen në dispozicion të gjitha shkresat dhe provat me çka u mundësohet shqyrtimi i të gjitha fakteve dhe çështjeve juridike të lëndës, relevante për përfundimin e detyrës së caktuar në provim.

6. Prej shkresave të çështjes në të cilat bazohet testi me shkrim hiqen të gjitha shkresat, emrat dhe shenjat të cilat do ta rrezikonin objektivitetin e procedurës së testit.

7. Testi me shkrim mbahet brenda një dite, me ç'rast kandidatët testohen lidhur me dy raste, secili në kohë prej maksimum 3 (tre) orësh.

#### **Neni 17**

##### **Kriteret për vlerësimin e testit me shkrim**

1. Kriteret për vlerësimin e rasteve të testit me shkrim, janë:

1.1. përshkrimi i gjendjes faktike dhe aplikimi i të drejtës materiale (deri në 10 pikë);

1.2. aplikimi i të drejtës procedurale dhe struktura e vendimit (deri në 10 pikë);

1.3. vlerësimi dhe analizimi i provave, argumentimi dhe logjika e arsyetimit qartësia, të kuptuarit, të përmbledhurit dhe mënyra e të shkruarit (deri në 10 pikë);

2. Provimi me shkrim ka gjithsej 60 pikë, përkatësisht secili rast nga 30 pikë.

#### **Neni 18**

##### **Vlerësimi i testit me shkrim**

1. Anëtarët e Komisionit për Rekrutim e vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme duke respektuar çdo kriter të cekur në nenin 18 të kësaj Rregulloreje.

2. Komisioni për Rekrutim e vlerëson testin me shkrim më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij.

3. Testi me shkrim vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Rekrutim, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar nga ana e Komisionit.

4. Komisioni për Rekrutim, me rastin e vlerësimit të testit me shkrim me qëllim të ruajtjes së konfidencialitetit, vepron në përshtatshmëri me rregullat për hartim të provimit.
5. Pakoja me plikot ku janë vendosur testet e kandidatëve hapen vetëm në ditën e vlerësimit dhe në prezencë të Komisionit për Rekrutim.
6. Komisioni për Rekrutim e bënë vlerësimin vetëm në bazë të kodit sekret të testit me shkrim të kandidatit.
7. Komisionit për Rekrutim, me rastin e vlerësimit të testit me shkrim i vihet në dispozicion vetëm plikojat me teste. Pas hapjes së plikos ku ndodhet testi, në secilën fletë të testit shënohet kodi i shënuar në atë pliko.
8. Komisioni për Rekrutim pas vlerësimit të testit me shkrim e krijon listën përfundimtare të kandidatëve që e kanë kaluar testin me shkrim duke i renditur kodet sekrete me numrin më të madh të pikëve.
9. Kryetari i Komisionit për Rekrutim verifikon përputhjen e kodeve sekrete në të dy plikot dhe emrit të kandidatit, të vendosura sipas nenit 20 paragrafi 25 dhe 26 të kësaj Rregulloreje dhe pastaj e harton listën e kandidatëve sipas renditjes alfabetike.
10. Kandidati i cili në të dy rastet e testit me shkrim nuk ka grumbulluar së paku katërdhjetë (40) pikë, konsiderohet se nuk e kalon testin me shkrim dhe si rrjedhojë nuk i nënshtrohet procesit të mëtejshëm të provimit.

#### **Neni 19**

##### **Njoftimi për rezultatet e testit me shkrim**

1. Kandidatët njoftohen për rezultatet e testit me shkrim pas vlerësimit dhe verifikimit të rezultateve nga Komisioni për Rekrutim.
2. Lista përfundimtare e kandidatëve të cilët e kanë kaluar testin me shkrim, me emër dhe mbiemër publikohet në web faqen e KPK-së dhe PSh-së. Kodi sekret dhe numri i pikëve të fituara, në këtë fazë nuk publikohen.

#### **Neni 20**

##### **Administrimi i provimit**

1. Para fillimit të secilës pjesë të provimit, zyrtarët e autorizuar të KPK-së e verifikojnë identitetin e kandidatëve i cili i nënshtrohet provimit duke e shikuar dokumentin e tij të identifikimit me fotografi.
2. Testi kualifikues dhe testi me shkrim mbahen në ditë të ndryshme.

3. Nëse kandidati nuk paraqitet në kohën e caktuar për provim ose nëse para fillimit të provimit deklaron se heq dorë, gjegjësisht nëse nuk është i mundur identifikimi i kandidatit, konsiderohet se ai nuk i është nënshtruar provimit.
4. Kandidati i cili heq dorë nga provimi i filluar, konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin.
5. Provimit mund t'i nënshtrohen vetëm kandidatët nga lista e cila është publikuar në njoftimin e KPK-së siç është përcaktuar në nenin 15 dhe 19 të kësaj Rregulloreje.
6. Kandidatëve u lejohe të hyjnë në vendin e caktuar për provim në bazë të shenjës dalluese të shpërndarë gjatë regjistrimit në ditën e provimit. Shenjën e tillë kandidatët e marrin vetëm për testin kuaifikues dhe testin me shkrim me obligim që ta bartin gjatë gjithë kohës së provimit.
7. Provimi drejtohet dhe mbikëqyret nga Kryetari i Komisionit për Rekrutim i mbështetur nga Administratori i Rekrutimit dhe provimit.
8. Nëse ka më shumë salla ku mbahet provimi, secila sallë do të jetë nën kontrollin e mbikëqyrësit të sallës i cili caktohet nga Administratori i rekrutimit dhe provimit. Detyrat e mbikëqyrësit të sallës janë drejtimi dhe kontrollimi i administrimit të provimit në sallën e caktuar. Mbikëqyrësi i sallës i raporton Administratorit të rekrutimit dhe provimit.
9. Administrimi i provimit do të vëzhgohet nga përfaqësues të pavarur (vendor dhe ndërkombëtarë) të cilët raportojnë tek Administratori i rekrutimit dhe provimit për çdo parregullsi dhe shkelje të rregullave të organizimit të provimit. Mundësisht, sallat do të pajisen edhe me kamera të vëzhgimit që mund të shërbejnë më vonë edhe si provë në procesin e vendosjes për ankesë.
10. Në vendin ku mbahet provimi, kandidatët duhet të ulen në vendin e caktuar aty për aty nga mbikëqyrësi i sallës. Kandidatët të cilët vijnë në provim pas mbylljes së derës së sallës, nuk do të lejohet të hyjnë në provim.
11. Në provim kandidati duhet të ketë dokumentin e identifikimit me fotografi i cili duhet të qëndrojë mbi tavolinë ku është i ulur kandidati gjatë gjithë kohës sa zgjatë provimi.
12. Kurrfarë çanta dore, letra, dosje, stilolapsa, lapsa, fletore, dokumente, telefona, kompjuter, kamera, dëgjuese/kufje, aparat MP3 apo ndonjë pajisje tjetër elektronike të çfarëdo lloji, nuk janë të lejuara në sallën e provimit. Shkelja e kësaj rregulle e zbuluar para shpërndarjes së provimit do të rezultojë me marrjen e përkohshëm të mjetit deri në përfundim të provimit. Nëse shkelja zbulohet gjatë apo pasi të ketë përfunduar provimi, do të rezultojë me shpalljen e provimit të pavlefshëm dhe diskualifikimin e kandidatit nga provimi.
13. Kurrfarë lloj shënimesh, kopje të ligjeve, material lexues apo material për shkrim (letër e pastër) nuk lejohet të sillen nga kandidati në vendin ku mbahet

provimit. Nëse shkelja e tillë zbulohet para përfundimit të provimit, ai do të shpallet e pavlefshëm dhe kandidati diskualifikohet nga provimi.

14. KPK do të ofrojë letër, stilolapsa dhe materialet e nevojshme për mbajtjen e provimit.

15. Nuk do të tolerohet asnjë lloj mashtrimi dhe çdo tentim për mashtrim, madje edhe nëse ai është i pasuksesshëm, konsiderohet shkelje e rregullave të provimit dhe sjellë si rezultat diskualifikimin e kandidatit nga provimi.

16. Kur fillon provimi, të gjitha bisedat e kandidatëve ndërpriten dhe mbikëqyrësi i sallës lexon udhëzimet e provimit. Pas kësaj mbikëqyrësi i sallës mund t'i përgjigjet pyetjeve të kandidatëve që kanë të bëjnë vetëm me udhëzimet.

17. Me njoftim nga mbikëqyrësi i sallës, koha për pyetje përfundonë dhe kandidatët nuk lejohet që të flasin me njëritjetërin apo me dikë tjetër derisa të dalin nga salla e provimit.

18. Shpërndarja e provimit, plikove dhe materialeve shtesë bëhet sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit të sallës.

19. Hapja e pjesëve të provimit nuk lejohet derisa të mos jepet udhëzimi për një gjë të tillë nga mbikëqyrësi i sallës. Shkelja e kësaj rregulle rezulton me heqjen e 5 pikëve nga rezultati i asaj pjese të provimit ose diskualifikimin e kandidatit.

20. Nuk lejohet shkrimi i emrit të kandidatit, shkrimi i numrave apo vendosja e ndonjë shenje tjetër dalluese në ndonjë prej fletëve të provimit, përveç emrave dhe numrave të dhënë në test. Në rast të veprimit të kundërt nga kandidati, ai do të diskualifikohet.

21. Në momentin e shpërndarjes së provimit, kandidatët nuk lejohet të bisedojnë, të marrin apo japin ndihmë nga njëri tjetri apo dikush tjetër, derisa ndodhen në sallën e provimit. Gjithashtu gjatë tërë kohës së provimit, kandidatët nuk lejohet që të provojnë të komunikojnë me njëri tjetrin nëpërmjet mjeteve të komunikimit jo verbal (me shenja, gjeste, lëvizje, të folur pa zë apo ndonjë mënyrë tjetër). Mos respektimi i kësaj rregulle rezulton me largimin e menjëhershëm të kandidatit dhe diskualifikimin e tij nga provimi.

22. Kandidatët nuk mund të dalin nga salla e provimit gjatë kohës së provimit. Ata mund të lejohen të dalin vetëm të shoqëruar dhe kur e përfundojnë pjesën përkatëse të provimit dhe e mbyllin atë në pliko.

23. Kur të përfundojë koha e caktuar për pjesën e provimit, mbikëqyrësi i sallës jep shenjë për ndaljen e punës dhe kandidatët duhet që menjëherë të ndalin punën. Në rast të kundërt kandidatit do t'i hiqen 5 pikë nga numri i përgjithshëm i asaj pjese të provimit apo provimi i tij shpallet i pavlefshëm dhe kandidati diskualifikohet nga provimi.

24. Kur të jepet shenja, gjatë kohës ndërmjet dy pjesëve të provimit, kandidatët menjëherë vendosin testin në plikon e shpërndarë për këtë qëllim dhe e mbyllin plikon.

25. Në fund të provimit, kandidatëve u shpërndahet një pliko e vogël brenda të cilës ka një letër të vulosur ku kandidati duhet të shkruaj emrin, mbiemrin e tij dhe pastaj e mbyllë atë. Pliko e vogël së bashku me plikon e madhe në të cilën ndodhen testet, merret nga Administratori i rekrutimit dhe provimit në përfundim të provimit.

26. Administratori i rekrutimit dhe provimit vendos një numër (kod sekret) në të dy plikot njëkohësisht, i vulos ato dhe i vendosë në një pako të sigurtë e cila poashtu vuloset. Pako e mbyllur dhe e vulosur vendoset për ruajtje në një vend të sigurt në KPK dhe është nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komisionit për Rekrutim.

## Neni 21

### Procesi i vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve

1. Procedurës së vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale do t'i nënshtrohen të gjithë kandidatët që e kanë kaluar testin me shkrim, para se të janë ftuar për intervistën me gojë.

2. Procedurat e vlerësimit përfshijnë vlerësimin e integritetit personal dhe aftësitë profesionale të kandidatit duke përfshirë aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me zell, me vendosmëri dhe përgjegjësi siç parashihet me Ligjin për KPK-në.

3. Procedura e vlerësimit do të bëhet përmes verifikimit të informatave të siguruara nga kandidati dhe çfarëdo informacioni tjetër relevant që vendos të kërkojë Komisioni për Rekrutim, përfshirë informatat lidhur me përvojën e punës dhe performancën, publikimet dhe dokumentet profesionale dhe akademike, informacionin për masat eventuale disiplinore dhe sjelljet jashtë zyrës si dhe historikun mbi të kaluarën penale.

4. Procesi i vlerësimit duhet të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat mbrohen të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe me qëllim që të sigurohen informata relevante për të zbardhur personalitetin, përvojën profesionale si dhe personale të kandidatit.

5. Komisioni për Rekrutim do të ndihmohet për vlerësim të kandidatëve nga zyrtarët përgjegjës të KPK-së.

6. Kandidatët kanë të drejtë të njoftohen dhe t'i shikojnë dokumentet e mbledhura dhe draft dokumentacionin jo më herët se dhjetë (10) dhe jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së intervistës me gojë.

7. Procedura e vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale është përfshirë si pjesë e intervistës me gojë, në të cilën kandidatët po ashtu pyeten për integritetin e tyre personal dhe aftësitë profesionale, duke iu dhënë mundësi për të

konfirmuar, plotësuar apo refuzuar vlerësimin e bazuar në verifikimin e dokumenteve dhe informatave të kërkuara.

## Neni 22 Intervista me gojë

1. Qëllimi kryesor i intervistës me gojë është vlerësimi i aftësive për komunikim të kandidatit dhe logjika e argumentimit të fakteve përfshirë por pa u kufizuar në prezantimin e tyre në publik. Gjithashtu do të vlerësohen njohuritë dhe aftësitë e kandidatëve për argumentim dhe përgjigje adekuate nën presion të kohës.

2. Intervista me gojë nuk do të fillojë derisa të përfundojë shqyrtimi i gjitha ankesave nga Komisioni për Rishqyrtim.

3. Në ditën e intervistës me gojë kandidati informohet për përbërjen e Komisionit për Rekrutim, dhe i kërkohet që menjëherë të deklarohet nëse kërkonë përjashtimin e ndonjërit nga anëtarët e Komisionit për Rekrutim për shkak të dyshimit në paanshmërinë apo objektiviteti të tyre. Për përjashtim e anëtarit të komisionit vendos Komisioni për Rekrutim me shumicë të votave.

4. Gjatë intervistës me gojë do të përdoret një qasje e njëjtë metodologjike për të gjithë kandidatët.

5. Komisioni për Rekrutim mund të shtrojë pyetje edhe duke u bazuar në informatat që janë marrë gjatë procesit të vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve, duke ia mundësuar kandidatit që ta dëshmojë këtë edhe në intervistën me gojë.

6. Pyetjet që përdoren gjatë intervistës me gojë janë standarde për të gjithë kandidatët që aplikojnë për të njëjtën pozitë. Brenda pyetjeve të së njëjtës fushë mund të përdoren një sërë pyetjesh të standardizuara. Anëtarët e Komisionit për Rekrutim mund të shtrojnë një sërë pyetjesh shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidati.

7. Komisioni për Rekrutim mund të shtrojë pyetje edhe duke u bazuar në informatat që janë marrë gjatë procesit të vlerësimit të integritetit personal të kandidatëve.

8. Pyetjet të cilat mund të përdoren gjatë intervistës me gojë duhet të përgatiten në atë mënyrë që të nxjerrën informata që janë relevante me kriteret për emërim siç parashihet në Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin për KPK-në.

9. Fushat e pyetjeve dhe vlerësimi i përgjigjeve në intervistën me gojë bëhet sipas formularit të përgatitur nga Komisioni për Rekrutim.

10. Intervista me gojë dhe procedura përfundimtare e vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale vlerësohet me më së shumti 40 pikë, prej të cilave më së shumti 15 pikë janë për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale siç përcaktohet me nenin 21 të kësaj Rregulloreje.

### Neni 23 Rezultatet preliminare të provimit

1. Pas përfundimit të provimit me gojë dhe procedurës së vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale, bëhet numërimi i rezultateve të intervistës me gojë dhe përgatitja e listës me qëllim të shpalljes së rezultateve të provimit. Me këtë rast rezultateve të intervistës me gojë dhe procedurës së vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale i shtohen ato të testit me shkrim.
2. Lista që publikohet pas përfundimit të provimit me gojë konsiderohet listë me rezultate preliminare të provimit.
3. Rezultatet preliminare të kandidatëve publikohet në web faqen e KPK-së dhe PSh-së. Njëftimi përmabanë emrin, mbiemrin dhe numrin e pikëve të arritura nga kandidati në testin me shkrim dhe intervistën me gojë.

### Neni 24 Rezultatet përfundimtare të provimit

1. Rezultatet përfundimtare mbi suksesin e një kandidati llogariten mbi bazën e pikëve të arritura në testin me shkrim, intervistën me gojë dhe vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale.
2. Provimin konsiderohet se e kalojnë kandidatët të cilët kanë arritur rezultatet më të larta dhe janë në kuadër të numrit kandidatëve të përcaktuar nga KPK me konkurs, me kusht që të kenë arritur së paku 60 pikë në provimin me shkrim, intervistën me gojë dhe vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale.
3. Komisioni për Rekrutim, me rastin e vlerësimit të rezultateve të provimit, kandidatin mund ta vlerësoj nga një (1) deri në maksimumin e pikëve të përcaktuar me këtë Rregullore.
4. Listë përfundimtare e provimit konsiderohet lista e publikuar pas vendimit përfundimtarë të Komisionit për Rishqyrtim lidhur me ankesat e kandidatëve siq përcaktohet me nenin 25 të kësaj Rregulloreje.
5. Rezultatet përfundimtare të kandidatëve që e kanë kaluar me sukses provimin publikohet në web faqen e KPK-së dhe PSh-së. Njëftimi përmabanë emrin, mbiemrin dhe numrin e pikëve të arritura nga kandidati në testin me shkrim dhe intervistën me gojë.

### Neni 25 E drejta në ankesë

1. Kandidatët kanë të drejtë ankesë për testin kualifikues, testin me shkrim dhe intervistën me gojë, në afat prej tre (3) ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve mbi bazën e njoftimit të bërë nga nenet 15.2, 20.2 dhe 23.3 të kësaj Rregulloreje.



2. Ankesat e kandidatëve nga paragrafi 1 i këtij neni, shqyrtohen nga Komisioni për Rishqyrtim i KPK-së në afat prej 5 ditësh nga dita e përfundimit të afatit për ankesë.

3. Në rast se Komisioni për Rishqyrtim, pas vlerësimit të ankesës gjenë se janë bërë shkelje të rregullave rreth organizimit të testit kualifikues, testit me shkrim dhe intervistës me gojë, siç është përcaktuar me këtë rregullore, lidhur me ankuesin mund të marr vendim që të përsëritet pjesa përkatëse e provimit.

4. Nëse Komisioni për Rishqyrtim vendosë që të përsëritet pjesa përkatëse e provimit, provimi organizohet brenda pesë (5) ditësh nga vendimi i Komisionit për Rishqyrtim. Me këtë rast, në provim do të përdoret grupi i mbetur i provimit nga procesi i hartimit të tij, ndërsa rezultatet e pjesës së përsëritur të provimit do të merren në konsiderim me rastin e hartimit të listës përfundimtare të provimit.

5. Në rast se Komisioni për Rishqyrtim gjenë se janë bërë gabime teknike me rastin e llogaritjes së pikëve të testit kualifikues, testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ndërsa me rastin e shqyrtimit të ankesës vërtetohet se kandidati renditet në grupin e kandidatëve që e kanë kaluar pjesën përkatëse të provimit, ai kandidat do të futet në listën e kandidatëve që e kanë kaluar atë pjesë të provimit.

6. Pas shqyrtimit të ankesave për testin kualifikues, testin me shkrim dhe intervistën me gojë, KPK publikon listën siç përcaktohet me nenet 15.2, 20.2, 24.4 dhe 24.5 të kësaj Rregulloreje dhe kjo konsiderohet listë përfundimtare e provimit.

#### **Neni 26**

#### **Raporti për organizimin e provimit**

KPK, në përfundim të procesit të provimit së bashku me publikimin e rezultateve përfundimtare publikonë raportin final të Komisionit për Rekrutim përmes të cilit përshkruhet rrjedha e tërë procesit të organizimit të provimit.

#### **Neni 27**

#### **Ruajtja e provimit dhe dosjeve**

1. Provimi ruhet dhe arkivohet së bashku me dosjen e kandidatëve të cilët e kanë kaluar atë, në bazë të rregullave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare.

2. Dosjet e kandidatëve të cilët nuk e kanë kaluar provimin, u kthehen atyre pas regjistrimit të të dhënave relevante për ruajtje.

3. Qasja në dokumentet e ruajtura sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

## **Neni 28** **Përrjashtimi**

1. Sjjellja që është në kundërshtim me rregullat e përcaktuara me nenin 22 të kësaj Rregulloreje do të rezultojnë me përrjashtimin e kandidatit nga provimi, përveç nëse me të njëtin nen nuk është përcaktuar ndryshe.

2. Në rast të përrjashtimit të kandidatit nga provimi, për shkak të shkeljes së rregullave të nenit 22 të kësaj Rregulloreje, Komisioni për Rekrutim mund të marrë vendim me të cilin kandidatit i ndalohet qasja në provim në periudhën kohore prej një viti nga data e shkeljes së rregullave të provimit.

## **Neni 29** **Mbrojta e të dhënave mbi procedurën e provimit**

Fshehtësia e të dhënave lidhur me kandidatët që i janë nënshtruar provimit si dhe të rezultateve të provimit, përfundon pas publikimit të rezultateve përfundimtare të provimit dhe raportit për organizimin e provimit.

## **Neni 30** **Përgjegjësia për zbulimin e të dhënave**

Kushdo që zbulon çfarëdo të dhëne apo informate lidhur me procesin e rekrutimit dhe provimit, në mënyrë të paautorizuar, në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe këtë rregullore, trajtohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës dhe zbulim fshehtësisë zyrtare.

## **Neni 31** **Evidenca për personat të cilët i janë nënshtruar provimit**

1. KPK e mban evidencën e kandidatëve të cilët i janë nënshtruar provimit.
2. Evidencën e mban NjShPP në formën elektronike dhe ajo përmban të dhënat personale të kandidatëve, kodet identifikuese të tyre si dhe të gjitha materialet e tyre që kan të bëjnë me provimin.
3. Evidenca mbahet veçmas për çdo proces të organizimit të provimit dhe mbyllet në momentin e përfundimit të këtij procesi.
4. Me kërkesë me shkrim, pas përfundimit të provimit kandidati ka të drejtë te ketë casje në të dhënat e përmendura në paragrafin dy (2) të këtij neni.

1. Të dhënat e evidencës ruhen dhe janë sekrete.

**Neni 32**  
**Procesi konsultativ**

1. Para dorëzimit të propozimeve për emërim, KPK kërkon mendimin e prokurorisë përkatëse në të cilën kandidati është propozuar për emërim.
2. Në rast së prokuroria përkatëse shpreh mendim jo të mirë për kandidatin atëherë duhet që të ketë një arsyetim në formë të shkruar.

**Neni 33**  
**Përzgjedhja e kandidatëve më të suksesshëm**

1. Komisioni për Rekrutim e përpilon listën e konkurrenës sipas pikëve të fituara në provim. Renditja e kandidatëve bëhet sipas numrit të pikëve të fituara në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Renditja në listë përfundon te numri i kandidatëve të përcaktuar me shpallje nga KPK. Në rast se kandidatët e fundit në listë kanë pikë të njëjta, konsiderohen se ata e kanë kaluar provimin.
2. Kryetari i Komisionit për Rekrutim e dërgon në KPK listën përfundimtare të kandidatëve të cilët e kanë kaluar provimin dhe raportin përfundimtar të provimit.
3. Caktimi i dhe shpërndarja e kandidatëve për prokurorë në regjione të Republikës së Kosovës bëhet nga KPK me propozim të Komisionit për Rekrutim.
4. Të drejtë që të zgjedhin prokurorinë ku mund të rekomandohen për emërim e kanë vetëm pesë (5) kandidatët me numrin më të madhë të rezultateve në listën përfundimtare të provimit.

**Neni 34**  
**Propozimi për Dekretim i Prokurorëve të Shtetit**

KPK merr vendim për propozimin e një kandidati te Presidenti i Republikës së Kosovës për emërim si prokuror i shtetit. Në rast të mospropozimit të një kandidati te Presidenti, vendimi i KPK-së duhet të arsyetohet me shkrim.

**Neni 35**  
**Vlerësimi i Prokurorëve të Shtetit pas trajnimit dhe mandatit fillestar**

Prokurorët e Shtetit vlerësohet në përfundim të trajnimit fillestar si dhe në përfundim të mandatit fillestar në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

**Neni 36**  
**Riemërimi i Prokurorëve të Shtetit**

1. Komisioni për Vlerësimin e Performancës dorëzon në KPK rekomandimin e arsyetuar për riemërimin apo jo të një prokurori.

2.KPK vendos për ri emërimin apo jo të prokurorit brenda dyzet e pesë (45) ditëve pas pranimin të propozimit nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës, në pajtim me kriteret dhe procedurat e caktuara me legjislacionin në fuqi.

3. KPK e njofton prokurorin lidhur me procesin e riemërimit përmes një vendimi të arsyetuar me shkrim.

4. Para dorëzimit të propozimeve për riemërim, KPK kërkon mendimin e prokurorisë përkatëse në të cilën kandidati është propozuar për riemërim.

5. KPK e dorëzon propozimin për riemërim të prokurorit përkatës të Presidenti i Republikës.

### **Neni 37** **Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e KPK-së nr. 03/2013 të datës 23 shtator 2013.


2. Organizimi i provimit për prokurorë nga radha e komuniteteve jo-shumicë, me qëllim të integritimit në sistemin prokurorial të Kosovës, bazuar në Marrëveshjen e parë të Parimeve që Qeverisin Normalizimin e Marrëdhënieve, ashtu siç është ratifikuar me Ligjin për Ratifikimet, zbatohet sipas Rregullores nr. 01/2015 e miratuar nga KPK me 07 gusht 2015.

3. Kandidatët të cilët e kanë përfunduar provimin dhe trajnimin fillestar të organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës do ti nënshtrohen vetëm intervistës me gojë dhe procesit të vlerësimit të integritetit personal dhe atësive profesionale të kandidatëve, siç është përcaktuar me nenin 23 dhe 24 të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 38** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KPK.

Prishtinë, datë 01 dhjetor 2015

Aleksander Lumezi  
  
Kryeprokuror i Shtetit/Kryesues i KPK

